




ALEANCA PËR FËMIJËT SHQIPËRI



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

KARTA RAJONALE RAPORTUESE – QARKU TIRANË

“Buxhetimi për Fëmijë” për vitin 2011



QARKU – TIRANË
Eksperte – Rajonale
Arsa Agalliu

Lista e Shkurtimeve:

Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Tirane
ACA	- Aleanca për Fëmijët në Shqipëri
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
NJDF	- Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
MASH	- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
DAR	- Drejtoria Arsimore Rajonale
ZA	- Zyra Arsimore
DSHPSH	- Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore - Qarku – Tirane
MB	- Ministria e Brendshme
PAK	- Personat me Aftësi të Kufizuara
OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë

I. Parathënie dhe Falënderime

“Observatori për të Drejtat e Fëmijës” është një iniciativë ndërmjet UNICEF dhe “Aleanca për Fëmijët”, që ka ngritur mekanizmin për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajoni. Zyra e Observatorit, harton raporte bazuar në realizimin e të drejtave të fëmijës me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke u mbështetur në analizën e 140 treguesve të ndryshëm. Në rajonin e Tiranës, Observatori ushtron veprimtarinë e tij që në Janar të vitit 2011.

“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” - Tirane ka një rrjet të gjerë bashkëpunorësh Publikë dhe Jopublikë. Observatori - Tirane ka ndërtuar bashkëpunime me shumë aktorë lokalë të rëndësishëm në Qarkun e Tiranës, si: bashkitë dhe komunat, institucionet shëndetësore, arsimore, të shërbimeve sociale, komisariatet e policisë dhe zyrat e punësimit.

Në punën e saj periodike, zyra e Observatorit Tiranë është e angazhuar në mbledhjen e treguesve lokalë për vitin 2010 e në vazhdim. Këto të dhëna janë përpunuar dhe bërë publike në faqen e Aleancës për Fëmijët Shqipëri, (www.aca.org.al). Observatori Tiranë ka një bashkëpunim të mirë me zyrën e Qarkut Tiranë. Gjatë fundit të vitit 2012, Observatori ka luajtur një rol të rëndësishëm mes zyrës së Qarkut Tiranë dhe UNICEF, me qëllim për të nxitur Qarkun Tiranë që të angazhohej në realizimin e strategjisë rajonale për të drejtat e fëmijëve. Dhe sot kjo strategji është në proces hartimi nga kjo zyrë, proces i cili ka filluar në Mars 2012. Së fundmi, Observatori Tiranë ndërmori nismën e realizimit të një studimi në nivel Qarku lidhur me e “Buxhetimit të Fëmijëve” për vitin 2011.

Për realizimin e këtij studimi, falënderoj për bashkëpunimin institucional, aktorët e rëndësishëm vendorë, si: Këshilli i Qarkut-Tiranë (Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore), Institucionet Arsimore dhe Shëndetësore, Shërbimin Social Shtetëror – Tirane.

Një falënderim i veçantë i dedikohet UNICEF, që është mbështetja financiare për realizimin e këtij studimi si edhe Znj. Suzana Sakiqi, Koordinatorja Kombëtare e “Aleancës për Fëmijët” në Shqipëri, e cila ka venë në jetë këtë projekt. Mbështetja më e rëndësishme humane dhe profesionale ka ardhur nga Znj. Elma Tershana (Drejtoreshë e Projektit) dhe Mina Mata (Administratore Kombëtare e të dhënave) nga Zyra - Qendrore e “Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve” në Tiranë.

II. Hyrja

Qëllimi i studimit është analizimi dhe krahasimi i tendencave të ‘‘Buxhetimit për Fëmijë’’ në sektorët: arsim, shëndetësi, ndihmë ekonomike, pjesëmarrje nga fondet buxhetore të pushtetit - qendror si edhe nga fondet buxhetore të qeverisjes vendore. Studimi analizon buxhetimin në vitin 2011 si edhe bën krahasimin e fondeve buxhetore në total kundrejt fondeve të planifikuara dhe shpenzuara për fëmijë. Çështja e buxhetimit është adresuar në këtë studim për shkak të specifikave të qarkut të Tiranës, i cili duke qenë edhe kryeqyteti i vendit, në përbërje të tij ka shumë kategori vulnerabël dhe të margjinalizuara, si fëmijët romë, me aftësi të kufizuar, fëmijët që i përkasin familjeve të varfra etj. Buxhetimi është një çështje që kërkon koordinimin dhe bashkërendim veçantë që nga pushteti qendror deri te ai lokal, në mënyrë që fondet e alokuara nga pushteti qendror dhe të hartuara e draftuara nga pushteti vendor të jenë sa më konform nevojave dhe prioriteteve të grupeve të ndryshme të margjinalizuar përpos zonave dhe rajoneve ku ato jetojnë.

Objektivat e Studimit janë:

- Mbledhja e të dhënave sasiore në institucionet përkatëse për fondet buxhetore të pushtetit qendror dhe pushtetit të qeverisjes vendore për vitin 2011 në Qarkun Tiranë;
- Mbledhja e të dhënave të fondeve buxhetore në total nga pushteti qendror për sektorët: arsim, shëndetësi, ndihmë ekonomike, aftësia e kufizuar, shpenzime personeli, duke synuar identifikimin e buxheteve të planifikuara dhe shpenzuara për fëmijë.
- Mbledhja e informacioneve për fondet buxhetore të qeverisjes vendore për: arsim, qendra sociale, terreneve sportive dhe argëtuese, të fokusuara kryesisht te fondi për fëmijë.

Ky studim synon që ti shërbejë institucioneve arsimore, shëndetësore, të mbrojtjes sociale dhe njësisive vendore. Nëpërmjet gjetjeve të këtij studimi, institucionet do të mund të reflektojnë mbi arsyet e mundshme që kanë influencuar në tendencën e uljes ose të ngritjes së fondeve buxhetore të pushtetit qendror dhe vendor, në përputhje me nevojat dhe potencialet për realizimin e programeve të zhvillimit me fokus fëmijë. Arsyeja e përzgjedhjes së temës ‘‘Buxhetimi për Fëmijë’’ për qarkun e Tiranës është se fëmijët (grupmosha 0-18 vjeç) zënë një numër të konsiderueshëm në qarkun Tiranë, duke përbërë 25% të popullatës ose 246,041 fëmijë, për vitin 2011. Një fakt i tillë, duhet të shërbejë për marrjen më shumë në konsideratë të fëmijëve, duke rritur shkallën e investimeve për këtë kategori dhe duke shtuar politikat në fokus të mirëqenies dhe interesit më të lartë të tyre.

Përshkrimi i buxhetimit

Hartimi i buxhetit realizohet mbi politika dhe programe të veçanta. Në këtë mënyrë buxheti i vitit 2011 është hartuar mbi bazë të ligjit nr 10355 datë 2.12.2010 ‘‘Për Buxhetin e vitit 2011’’. Buxhetimi lidhet me dokumente të ndryshëm strategjikë si: programi buxhetor, shërbimet e kujdesit parësor dhe publik, programi buxhetor i arsimit bazë, i mesëm i përgjithshëm dhe

¹¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2012.

profesional, si dhe buxhetimi me pjesëmarrje, ku Bashkia e Tiranës është një nga bashkitë pilot ku po zbatohet kjo praktikë.

Partnerët në buxhetim përfshijnë jo vetëm fondet buxhetore të alokuara nga pushteti qendror por edhe donatorë të ndryshëm.

Metodologjia:

Për realizimin e studimit të buxhetimit në nivel rajonal, jemi bazuar në:

- a) *Desk – Review* e cila përfshin rishikimin e dokumenteve, raporteve, ligjeve, studimeve kombëtare; Dokumentet që janë përdorur për realizimin e këtij studimi janë:
 - Programi buxhetor i arsimit bazë, i mesëm i përgjithshëm dhe profesional;
 - Programi buxhetor për shërbimet e kujdesit parësor dhe publik;
 - Ligji nr. 10355 datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”;
 - Projekt - buxheti 2011- 2013;
 - Relacion i projekt - buxhetit faktik 2011;
 - Udhëzimi i zbatimit të buxhetit 2011;
 - Buxhetimi me pjesëmarrje, udhëzues për pushtetin - vendor në Shqipëri.

- b) *Mbledhje informacionit/ të të dhënave* në lidhje me buxhetimin nga pushteti qendror dhe ai vendor, si dhe informacioni sasiorë i përcjellë nga Dega e Thesarit - Tiranë.

II. Analiza e të dhënave

Të drejtat e fëmijëve në vëmendjen lokale

Qarku i Tiranës ka një sipërfaqe prej 1586 km² me një popullsi të regjistruar prej 1,006,1012 të vendosur ne 183,770 familje³ dhe me një dendësi popullsie prej 634 banorë /km². Krahasuar me vitin 2010 ka një rritje popullsie prej 0.9% (8721 banorë)⁴. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Tiranë, totali i popullsisë së grupmoshës 0-18 vjeç për vitin 2011 është 246,041 banorë ose 25% e popullsisë totale të Qarkut Tiranë, duke pësuar një rënie me 2% nga popullata 0-18 e vitit 2010 (27% të popullatës ose 265,873 fëmijë për vitin 2010).

Të drejtat e fëmijëve janë ligjëruar dhe mbrohen sipas ligjit numër 10 347, datë 4. 11. 2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, i cili i vjen në mbrojtje të gjithë fëmijëve me shtetësi shqiptare, që ndodhen brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Të drejtat e fëmijëve, jo vetëm që duhet të ekzistojnë në parim, por duhet të marrin edhe mbështetjen e duhur nga mekanizmat institucional në nivel qendror dhe vendor, të përcaktuara nga ligji⁵. Në qarkun e Tiranës është ngritur dhe funksionon që nga viti 2011 Njësia për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF). Ndërsa ngritja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) është një proces më kompleks, pasi duhet të shtrihet në çdo mini-bashki të Tiranës, si dhe në çdo bashki dhe komunë të këtij Qarku.

² Zyra e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, 2012.

³ Shërbimi Social Shtetëror Tiranë, 2012.

⁴ Të dhënat primare janë marrë nga Zyra e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, 2012, ndërsa përlllogaritjet janë bërë nga Observatori Tiranë.

⁵ OBSH (2001), Deklaratë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës.

Këto mekanizma bashkëpunojnë edhe me institucionet e tjera publike si edhe me aktorët e shoqërisë civile me fokusin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

Aksesi ndaj buxhetimit

Republika e Shqipërisë, pas ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, ka ndërmarrë shumë nisma për realizimin e reformave gjithëpërfshirëse me synimin e përforcimit të mirëqenies dhe interesit më të lartë të fëmijës.

Qeveria Shqiptare në çdo fund viti harton dhe miraton buxhetin për vitin pasardhës, i cili është i specifikuar në zëra të veçantë. Përlllogaritja e buxhetit që shkon për fëmijët është kompleks dhe realizohet në saj të formulave të gatshme të koeficienteve duke u bazuar në këto programe buxhetore:

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, me programet buxhetore “arsimi bazë” dhe “arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe profesional”;
- Ministria e Shëndetësisë, me programet buxhetore “shërbimet e kujdesit parësor” dhe “shërbimet e kujdesit publik”;
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me programet buxhetore: “mbrojtja sociale” dhe “shanset e barabarta”;
- Zëri “shpenzime buxhetore për personelin” për të gjithë buxhetin qendror.

Gjithashtu për përlllogaritjen e buxhetit për fëmijë duhen analizuar fondet buxhetore të qeverisjes vendore për arsim, qendra sociale, art, kulturë, sport dhe shpenzimet për personelin e çdo njësie vendore. Për të përcaktuar buxhetin për fëmijë në qarkun e Tiranës, krahas informacionit mbi fondet buxhetore të buxhetit qendror dhe vendor, përlllogaritet edhe raporti i fëmijëve nga numri total i popullsisë së Qarkut Tiranë si dhe numri i familjeve dhe i fëmijëve. Me anë të përlllogaritjes së këtyre treguesve, pasi vendosen koeficientet e duhur, përlllogaritet buxheti për çdo fëmijë.

	Nr.fëmijëve	Nr.popullsisë	Nr.fëmijëve/Nr.popullsisë (%)	Nr.familjeve	Nr.fëmijëve/Nr.familjeve
a	b	c	d=b/c	e	f=b/e
Qarku Tiranë	246,041	1,006,101	24.45%	183,770	134%

Tabela 1: Numri i fëmijëve dhe raporti me numrin total të popullsisë dhe familjet për vitin 2011 për Qarkun Tiranë;

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, MB, Tiranë Korrik 2012.

Në tabelën 1 janë pasqyruar të dhënat të cilat shërbejnë për të përlllogaritur koeficientet e nevojshëm, të cilët do të ndihmojnë në përlllogaritjen indirekte të buxhetit për fëmijë.

3.1 Buxheti – qendror

Shpenzimet buxhetore për kujdesin shëndetësor

Shpenzimet në sektorin e shëndetësisë janë fonde nga të cilat fëmijët nuk përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj përlllogaritja e tyre bëhet në bazë të koeficienteve. Në fillim përlllogaritet financimi i sistemit shëndetësor për të gjithë popullsinë për të përcaktuar pjesën që shkon drejtpërsëdrejti për fëmijët.

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijëve/ Nr.popullsisë(%)	Buxheti për fëmijë në total (000 lekë)	Nr.i fëmijëve	Buxheti për çdo fëmijë (000 lekë)
a	b	c	d=b+c	e	f=d*e	g	i=f/g
Qarku Tiranë	15,303,142.16	1,465,260.72	16,768,402.88	24.45%	4,099,875	246,041	16.66

Tabela 2: Buxheti qendror për vitin 2011, për shëndetësinë në qarkun - Tiranë, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit, Tiranë, 2012, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, 2012.

Duke iu referuar informacionit të Tabelës 2, mund të themi se totali i shpenzimeve të buxhetit qendror për sektorin e shëndetësisë është 16,768,402.88 Lekë. Këto shpenzime janë të destinuara për të gjithë popullsinë dhe jo vetëm për fëmijët. Me anë të raportit të përqindjes së fëmijëve kundrejt totalit të popullsisë rezulton se shpenzimet në sektorin e shëndetësisë për fëmijët në vitin 2011 në qarkun e Tiranës janë 4,099,875 Lekë. Në vitin 2010 shpenzimet për fëmijët në sektorin e shëndetësisë në nivel kombëtar kanë qenë 3,104,094 Lekë⁶. Shohim se këto shpenzime për qarkun e Tiranës janë 32% më të larta krahasuar me shpenzimet kombëtare për shëndetësinë për vitin 2010.

Duke pjesëtuar buxhetin total për fëmijët me numrin total të fëmijëve themi se buxheti për fëmijë në sektorin e shëndetësisë është 16.660 Lekë.

Shpenzimet buxhetore për zhvillim dhe arsim

Shpenzimet buxhetore për arsimin parauniversitar nga pushteti qendror janë fonde nga të cilat fëmijët përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi përfshin shpenzime korrente dhe investime në institucione ku përfitues janë fëmijët.

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijëve në shkolla	Buxheti për fëmijë (000 lekë)
a	B	C	d=b+c	E	f=d/e
Qarku Tiranë	5,408,954.45	934,247.03	6,343,201.48	142,498	44.51

Tabela 3: Buxheti për vitin 2011 për arsimin parauniversitar për Qarkun Tiranë, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit Tiranë, 2013

Sipas informacionit të tabelës 3 totali i shpenzimeve për arsimin parauniversitar për vitin 2011 është 6,343,201.48 Lekë. Duke qenë se në sektorin e arsimit fëmijët janë përfituesit direkt të fondeve, atëherë nuk është e nevojshme të bëhet korrektim i këtij fondi me koeficientët e

⁶ UNICEF, *Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri*;

mësipërm. Krahasuar me shpenzimet për arsimin parauniversitar në nivel kombëtar të vitit 2010, të cilat kanë qënë 8,378,194 Lekë⁷, këto shpenzime janë 24.3% më të pak për qarkun e Tiranës. Numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parauniversitar publik dhe jo-publik në qarkun e Tiranës është 142,498 Lekë. Nga një raport i thjeshtë i totalit të shpenzimeve me numrin e fëmijëve që ndjekin arsimin parauniversitar, mund të themi se buxheti për fëmijë në sektorin e arsimit është 44,510 Lekë/fëmijë.

3.2 Buxheti - vendor/ lokal

Buxheti i qeverisjes lokale për fëmijët

Në ndryshim nga pushteti qendror, pushteti lokal ka përparësi veprimi për mbrojtjen dhe përkujdesin për shtresat në nevojë si edhe për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve, për shkak të njohjes më nga afër të nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve që i shërben. Përsa i përket shpenzimeve që janë të miratuara në buxhetin e qeverisjes vendore mund të përmendim: (1) shpenzimet për funksionet e veta (për administratën vendore, shërbimet publike) si dhe (2) shpenzimet për funksionet e deleguara (shpenzimet për mbrojtjen sociale, për arsim etj).

Buxhetimi me pjesëmarrje⁸

Buxhetimi me pjesëmarrje të gjerë është një mekanizëm, i cili u mundëson qytetarëve që të marrin pjesë në vendimmarrje në menaxhimin e të gjitha, ose të një pjese të burimeve aktive të financave publike të pushtetit lokal. Buxhetimi me pjesëmarrje ka për qëllim rritjen e transparencës, përgjegjësisë dhe përfshirjen sociale në qeverisje të çdo qytetari.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një filozofi dhe praktikë e re pune, e cila mundëson afrimin e komuniteteve lokale me proceset vendimmarrëse lidhur me buxhetin publik. Kjo praktikë e re financiare ka potencialin që të rrisë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve përsa i përket vendimmarrjes rreth buxhetit si dhe për të ndihmuar qeverinë për të përmirësuar transparencën, efikasitetin dhe përgjegjësinë mbi buxhetin. Buxhetimi me pjesëmarrje mund të konsiderohet si një nga mjetet që do të forcojë edhe më shumë procesin e duhur të decentralizimit në Shqipëri.

⁷ Ibid;

⁸Ekipi i Zhvillimit Social Rajoni i Evropës dhe Azisë Qëndrore (2006), *Buxhetimi me pjesëmarrje udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri*

III. Rekomandime

- Rekomandohen njësitë vendore që të zbatojnë rigorozisht ligjin për taksat vendore, me qëllim që të mbledhin të gjithë taksat vendore përkatëse, për një rritje efikase të buxhetit të tyre, me qëllim që të kenë sa më shumë fonde në dispozicion për zbatimin e programeve të ndryshme lokale.
- Rekomandohen njësitë e pushtetit vendor që të shfrytëzojnë mundësitë dhe burimet alternative për të maksimizuar të ardhurat e tyre vendore, në mënyrë që realizimi i projekteve dhe nismave të ndryshme lokale të mos jetë i kushtëzuar vetëm nga grantet e pushtetit qendror.
- Ngritja, fuqizimi dhe trajtimi i mekanizmave mbrojtës dhe referues të të drejtave të fëmijëve (NJDF dhe NJMF) si pjesë e një zinxhiri të pandarë për implementimin korrekt dhe maksimal të politikave sociale.
- Në përputhje me ligjin në fuqi të decentralizimit, decentralizimi fiskal duhet të zgjerohet në shumë forma si; vetëfinancimi dhe zgjerimi i të ardhurave vendore nëpërmjet taksës së pronës etj.

Bibliografia

- Ekipi i Zhvillimit Social Rajoni i Evropës dhe Azisë Qëndrore (2006), *Buxhetimi me pjesëmarrje udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri*
- Ligji vjetor i buxhetit nr. 10355 datë 2.12.2010.
- Ligji nr. 8379 datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9355 datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, botuar në fletoren zyrtare nr. 22, viti 2005, faqe 829.
- Ligji nr. 3766 datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor” (i ndryshuar), botuar në fletoren zyrtare nr. 16, viti 1963, faqe 312.
- OBSH (2001), *Deklaratë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës*.
- Programi Buxhetor Arsimit Bazë, Arsimit Mesëm dhe ai Profesional”.
- Programi Buxhetor Shërbimet e Kujdesit Parësor, Shërbimet e Kujdesit Publik”.
- Program Buxhetor i MPCSShB
- Projekt Buxheti PBA 2011- 2013, Ministria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit.
- Politikat e Përfshirjes Sociale për Fëmijët dhe Financimi i tyre në Shqipëri - UNICEF.
- Relacion mbi buxhetin faktik 2011.
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2004 -2015 e MASH-it, miratuar në 2004.
- Strategjia Kombëtare e Arsimit - parauniversitar 2009-2013 e MASH-it, miratuar në korrik, 2009.
- Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Shoqërore 2008-2012 e MPCSSHB, miratuar në Janar, 2008.

Aneks 1:

Buxheti –Kamzë⁹

Prioritetet e buxhetit 2011 synojnë:

- Rritjen progresive të të ardhurave në buxhet përmes luftimit të informalitetit, evazionit fiskal dhe korrupsionit në grumbullimin e të ardhurave.
- Rritjen e shpenzimeve kapitale (shpenzimeve për investime), në krahasim me shpenzimet korrente (shpenzimet për paga, sigurimet - shoqërore, shpenzimet operative), kjo e krahasuar edhe me vitet e mëparshme.

Parimet kryesore që e karakterizojnë këtë buxhet janë :

1. Decentralizimi i pushtetit - vendor nuk është kuptuar vetëm rritje e kompetencave, por një detyrim ligjor për të rritur nivelin e shërbimeve dhe stabilitetin e bashkëpunimit me qeverisjen qendrore.
2. Transparenca që do të siguroj për këshillin bashkiak dhe publikun e gjerë, të dhëna lehtësisht të disponueshme, të shpejta, të kuptueshme e të krahasueshme ndër vite.
3. Disiplina fiskale duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social.
4. Shpërndarja e burimeve të financimit duke pasur parasysh objektivat dhe strategjitë e qeverisë.
5. Përdorimi ekonomik, eficient, efektiv i gjithë të ardhurave që sigurohen nga taksapaguesit vendor, si dhe të fondeve buxhetore që vijnë nga qeveria në formën e transfertës së pakushtëzuar.
6. Përgjegjësi të qarta për menaxhimin e fondeve.
7. Respektim me rreptësi e përgjegjësi të të gjithë procesit.
8. Parashikimi, gjithë përfshirja (të ardhurat parashikohen në kufirin minimal të tyre, pra ato dhe mund të tejkalohen, në të kundërt shpenzimet planifikohen në kufirin max dhe nuk mund të tejkalohen, pa autorizimet e lejuara nga ligji, pa miratim nga Këshilli - Bashkiak).
9. Partneriteti publik – privat si një mjet efektiv për të pasur një ekonomi të qëndrueshme (pra biznesi është konsideruar gjithmonë si një partner i rëndësishëm).
10. Zhvillimi i decentralizimit varet dhe nga shkalla e perceptimit të decentralizimit nga qytetarët, për këtë arsye në evenimente të rëndësishme ku të ftuar janë dhe qytetarë, biznesmen, media etj.
11. Buxhetimi me pjesëmarrje (gjatë gjithë vitit) është komunikuar me komunitetin dhe është marrë mendim për llojin e shërbimeve që ato kanë më të domosdoshme dhe sidomos prioritetet e kryerjes së investimeve. Marrja e këtyre mendimeve dhe sugjerimeve nga qytetarët është bërë e mundur edhe në saj të vënies në punë te *one - stop - shop* (ndër më të mirët dhe eficientët në vend), pasi ka shumë lehtësira për qytetarët, pra pjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje.

⁹ Gazetë e Bashkisë Kamzë, "Kamza", dt.17.04.2013

12. Gjatë procesit të projekt - buxhetimit janë përdorur ide novatore për një qeverisje sa më të mirë, për të përmirësuar dhënien e shërbimeve, si dhe për t'ju shërbyer qytetarëve sa më shpejt (përfaqësimi i specialistëve nga të gjithë drejtoritë në one - stop - shop).
13. Gjatë gjithë procesit të projekt - buxhetimit ka funksionuar grupi për strategji buxhet dhe integrim i kryesuar nga kryetari i bashkisë me pjesëmarrjen e Zv/kryetarëve si dhe të gjithë drejtorët e drejtorive (grupi i ngritur me urdhër të kryetarit).
14. . Kryetari i bashkisë i propozon këshillit - bashkiak drejtimet kryesore të politikës së bashkisë si për vitin 2011 ashtu dhe për vitet 2012 e 2013. (Drejtimi kryesor i politikës së bashkisë është rritja e nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve, por sidomos rritja e nivelit të investimeve në rrugë).
15. Gjatë hartimit të projekt - buxhetit është punuar për një shpërndarje sa më të drejtë të shpenzimeve sidomos atyre për investime në raport proporcional në të gjithë territorin e bashkisë - Kamëz.
16. Gjatë hartimit të projekt – buxhetit, drejtorja e financës e ka koordinuar punën me të gjitha drejtoritë për një planifikim sa më real të të gjitha llojeve të shpenzimeve si ato për investime dhe ato për funksionim. Nga drejtorja e urbanistikës janë hartuar të gjitha pikat e projektit me matje reale në terren për të gjitha investimet duke hartuar preventiva sa më reale e të saktë.
17. Është bërë vazhdimisht monitorimi i buxhetit nëpërmjet:
 - a. Mbledhjes dhe analizës së të dhënave rreth aktivitetit të buxhetit;
 - b. Monitorimi jep informacion rreth përdorimit të fondeve të shpërndara.
18. Bashkëpunimi me shoqatën e bashkive (marrja pjesë në seminarët e organizuara për hartimin e “ projekt - buxhetit 2010 “, shkëmbimi i përvojës dhe me njësi të tjera të qeverisjes – vendore në lidhje me problemin në fjalë).
19. Krijimi i besimit për ndryshime të dukshme dhe të prekshme, që plotësojnë nevojat e shpresat e qytetarëve.
20. Besimi element i rëndësishëm për të krijuar marrëdhënie midis:
 - a. Komunitetit dhe qeverisjes - vendore;
 - b. Komunitetit të biznesit dhe qeverisjes – vendore.
 - c. Brenda organizimit të qeverisjes - vendore.
 - Të krijojë një kuptim të përbashkët se si besimi, kredibiliteti dhe parashikimi mundësojnë qeverisje të mirë.